LIGJ
Nr. 4/2018

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË VEÇANTË PËR NEGOCIMIN DHE LIDHJEN E KONTRATËS NDËRMJET SHTETIT SHQIPTAR DHE SHOQËRIVE "CENGIZ CONSTRUCTION & KALYON & KOLIN CONSTRUCTION", ME OBJEKT PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE MENAXHIMIN E AEROPORTIT TË VLORËS

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pikat 1 e 2, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj përcakton procedurën e veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës ndërmjet shtetit shqiptar dhe shoqërive "Cengiz Construction & Kalyon & Kolin Construction", me objekt projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e aeroportit të Vlorës.

Neni 2
Procedura e negocimit

Procedura e negocimit për lidhjen e kontratës do të ndiqet nga komisioni i negocimit të kontratës, i ngritur me urdhër të Kryeministrit, i cili kryesohet nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe në përbërje të tij ka anëtarë, përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Avokatura e Shtetit, Autoriteti i Aviacionit Civil dhe përfaqësues nga institucione të tjera që gjykohen të nevojshme, i cili fillon negociatat brenda 45 ditëve nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Komisioni i negocimit të kontratës vlerëson dhe negocion me shoqëritë "Cengiz Construction & Kalyon & Kolin Construction" propozimin e paraqitur prej tyre dhe harton projektkontratën finale të negociuar nga palët, shoqëruar me relacionin përmbyllës të negociatave.

Komisioni i negocimit të kontratës mund të asistohet nga një konsulent, i përzgjedhur sipas një procedure të veçantë, të përshpejtuar, që miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Projektkontrata, e shoqëruar me relacionin përmbyllës të negociatave, brenda një afati prej 90 ditësh nga data e nisjes së negociatave, i dërgohet për nënshkrim Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

Neni 3
Nënshkrimi i kontratës

Nënshkrimi i kontratës nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministri i Financave dhe Ekonomisë bëhet brenda afatit kohor prej 10 ditësh nga data e marrjes së projektkontratës dhe relacionit përmbyllës të negociatave.

Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministri i Financave dhe Ekonomisë mund t'i kërkojnë komisionit të negocimit të kontratës rishikimin e projektkontratës. Ky komision duhet të rinegociojë dhe t'ua paraqesë për nënshkrim ministrave projektkontratën, të shoqëruar me relacionin përmbyllës të negociatave, brenda afatit kohor prej 30 ditësh, duke filluar nga data e kthimit.

Neni 4
Miratimi i kontratës

Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministri i Financave dhe Ekonomisë dërgojnë për miratim në Këshillin e Ministrave projektligjin e hartuar nga komisioni i negocimit të kontratës, brenda 10 ditëve nga data e nënshkrimit të saj.

Kontrata miratohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Data e hyrjes në fuqi e kontratës do të jetë data e hyrjes në fuqi të ligjit, pas miratimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 1.2.2018

KRYETARI
Gramoz Ruçi